



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE

MINISTËR SHTETI PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES



Raporti
mbi trajtimin e ankesave dhe
sugjerimeve të sipërmarrjes
për muajin prill 2020



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYEMINISTRIA

MINISTËR SHTETI PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

Të nderuar miq sipërmarrës,

Në vijim të komunikimit me ju, në rolin e Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, me qëllim përditësimin tuaj mbi punën e bërë gjatë këtij muaji, lejomëni të ndaj me ju raportin e muajit prill 2020 si dhe trajtimin e ankesave në kuadër të njoftimeve periodike.

Në muajin prill, kemi vijuar kontaktin e drejtpërdrejtë me 1341 biznese, për të kuptuar problematikat e hasura prej tyre, të lidhura me situatën e krijuar nga COVID-19.

Gjithashtu, kemi zhvilluar takim online me përfaqësues të sektorit të importit dhe prodhimit lidhur me operimin e tyre në treg dhe vështiresitë që ata hasën, kryesisht të lidhura me lëvizshmërinë e punonjësve. Duke u përpjekur të përmirësojmë këtë të fundit, ndërmjetësuaam me AKSHI, ndërtimin e një sistemi më të thjeshtë në portalin e-albania, në mënyrë që të aplikojnë sipërmarrësit dhe punonjësit, të cilët janë të detyruar të jenë në lëvizje për tipologji të ndryshme dhe të mirëpërcaktuara të lëvizjeve.

Takimi i mbajtur online me kryetarë të shoqatave dhe dhomave të tregtisë, solli një diskutim të zgjeruar mbi masat e marra në dobi të biznesit , sikurse edhe mbi kërkesa specifike të cilat u adresuan nga përfaqësuesit.


Ndërkaq, përgjatë muajit prill u përballëm me një sërë kërkesash nga sektori fason lidhur me prodhimin dhe tregtimin e maskave mbrojtëse jo-kirurgjikale dhe për adresimin e mëtejshëm të kësaj çështjeje, zhvilluam një takim online me shume sipërmarrës nga ky sektor. Gjithashtu, krijuam kontakt të drejtpërdrejtë me një numër të madh të sipërmarrësve

nga sektori fason, lidhur me operimin e tyre sipas protokollit të kuq higjeno-sanitar, miratuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Si rezultat i vlerësimit të kërkesave të adresuara nga shoqatat dhe dhomat e tregtisë, lancimi i paketës së dytë dedikuar sipërmarrjes në vend, ishte një hap tejet pozitiv për të ndihmuar në operimin e bizneseve dhe punonjësve, duke i dhënë atyre mundësi të përballojnë situatën e vështirë.


Duke shpresuar në vijimin e komunikimit me ju, shpreh bindjen time të thellë se nëpërmjet bashkëpunimit ne mund të përmirësojmë klimën e të bërit biznes në vendin tonë.

Me konsideratën më të lartë,
Eduard Shalsi




Analiza e Ankesave Prill 2020


1. Shperndarja e ankesave në baza javore



2. Statusi i ankesave dhe trajtimi i tyre



3. Statusi dhe shpërndarja e ankesave sipas ministrive dhe bashkive



4. Statusi dhe shpërndarja e ankesave sipas ministrive dhe institucioneve të varësisë.

